



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 6 të Rregullores Nr.01/2018 për Marrëdhënie Pune, me datën 23.06.2018, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

## KONKURS

për plotësimin e vendeve të lira të punës

|                            |                              |
|----------------------------|------------------------------|
| <b>I. Pozita:</b>          | <b>Auditor i Rregullsisë</b> |
| <b>Numri i referencës:</b> | ARR/ZKA/09-06/18             |
| <b>Numri i pozitave:</b>   | Dy (2)                       |
| <b>Klasifikimi:</b>        | Profesional                  |
| <b>Grada:</b>              | ZKA/06                       |
| <b>Orët e punës:</b>       | 40 orë në javë               |
| <b>Kohëzgjatja:</b>        | Me kohë të pacaktuar         |
| <b>Vendi:</b>              | Prishtinë                    |

### Qëllimi i vendit të punës:

Pozita Auditor mbulon detyra profesionale me mbikëqyrje të kufizuar dhe me udhëzime të herë pas hershme nga udhëheqësi. Auditori kontribuon në zhvillimin e mëtutjeshëm të ZKA-së duke përkrahur risitë në procese të auditimit.

### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

1. Në mënyrë efektive koordinon punën e auditimit me Udhëheqësin e ekipit dhe ofron mbështetje profesionale në ekip;
2. Përfitimi i njohurive të plota rreth institucioneve të audituara dhe kuptueshmëri të plotë të çështjeve, prioriteteve dhe rreziqet që i ballafaqojnë ato (pako për njohjen e punës);
3. Ndihmon Udhëheqësin e Ekipit në planifikim të auditimit, duke përfshirë propozimin e programeve dhe metodave të auditimit;
4. Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga Udhëheqësi i Ekipit dhe Udhëheqësi i Departamentit;
5. Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
6. Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës për çdo fazë të auditimit dhe pas rishikimit të tyre njofton Udhëheqësin e Ekipit për përfundimin e tyre;
7. Ofron përkrahje profesionale duke kryer procedura analitike të të dhënave financiare dhe jo financiare;

8. Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike dhe gjykimet për të arritur në konkluzione të qëndrueshme në bazë të dëshmive të mbledhura;
9. Përgatitja e Letrave të Punës (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar;
10. Kryen detyra tjera të ngarkuara nga mbikëqyrësi.

**Kualifikimi shkollor:**

- Diplomë fakulteti;

**Përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet apo financa;

**Kërkesat tjera:**

- Të jetë i certifikuar në skemën e certifikimit për kontabilist, apo auditor i sektorit publik.

**Kompetencat e vendit të punës:**

- Të punuarit me njerëz;
- Respektimi i parimeve dhe vlerave;
- Shkrimi dhe raportimi;
- Aplikimi i ekspertizës dhe teknologjisë;
- Analizimi;
- Të mësuarit dhe hulumtimi;
- Planifikimi dhe organizimi;
- Ndjekja e udhëzimeve dhe procedurave;
- Adoptimi dhe reagimi ndaj ndryshimit
- Arritja e synimeve dhe objektivave personale të punës.

|                            |                                      |
|----------------------------|--------------------------------------|
| <b>II. Pozita:</b>         | <b>Auditor Junior i Performancës</b> |
| <b>Numri i referencës:</b> | AJP/ZKA/10-06/18                     |
| <b>Numri i pozitave:</b>   | Dy (2)                               |
| <b>Klasifikimi:</b>        | Profesional-Junior                   |
| <b>Grada:</b>              | ZKA/07                               |
| <b>Orët e punës:</b>       | 40 orë në javë                       |
| <b>Kohëzgjatja:</b>        | Me kohë të pacaktuar                 |
| <b>Vendi:</b>              | Prishtinë                            |

**Qëllimi i vendit të punës:**

Pozita Auditor Junior mbulon detyra profesionale me mbikëqyrje dhe udhëzime të herë pas herëshme nga udhëheqësi.

Auditori Junior kontribuon në zhvillimin e mëtutjeshëm të ZKA-së duke përkrahur risitë në procese të auditimit.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1. Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga Udhëheqësi i Ekipit (nën mbikëqyrje);
2. Pjesëmarrje aktive në propozimin e temave audituese në planifikimin strategjik dhe atë vjetor bazuar në hulumtimet e kryera;
3. Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara;
4. Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
5. Dhënia e konkluzioneve të sakta në bazë të gjykimit profesional duke u mbështetur në dëshmitë e mbledhura
6. Përgatitja e Letrave të Punës (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar
7. Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me kohë me Udhëheqësin e tij/saj,
8. Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
9. Kryen detyra tjera të ngarkuara nga mbikëqyrësi.

**Kualifikimi shkollor:**

- Diplomë fakulteti;

**Përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Tri (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre preferohet një (1) vit në auditimin e performancës; dhe

**Kërkesat tjera:**

- Të posedojë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze

**Kompetencat e vendit të punës:**

- Të punuarit me njerëz;
- Respektimi i parimeve dhe vlerave;
- Krijimi i lidhjeve dhe puna në rrjet;
- Paraqitja dhe komunikimi i informacionit;
- Shkrimi dhe raportimi;
- Aplikimi i ekspertizës dhe teknologjisë;
- Analizimi;
- Të mësuarit dhe hulumtimi;
- Planifikimi dhe organizimi;
- Ndjekja e udhëzimeve dhe procedurave;
- Adoptimi dhe reagimi ndaj ndryshimit
- Arritja e synimeve dhe objektivave personale të punës.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

Përzgjedhja e kandidatëve për pozitat e mësipërme bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2018 për Marrëdhënie Pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

### **Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Në Zyrën Kombëtare të Auditimit kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

### **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. “Musine Kokalari” nr.87- Prishtinë, të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës.

### **Dëshmitë mbështetëse**

**Kandidatët për të dy llojet e pozitave (I. dhe II.) aplikacionit duhet t’ia bashkëngjeshin kopjet e dokumentacionit si:**

- Dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Letër rekomandimet; dhe
- Kopjen e dokumentit personal të identifikimit.

Shpallja është e hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor me datën **23 qershor 2018** dhe mbetet e hapur deri më datën **8 korrik 2018**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

### **Shënim:**

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Vetëm formulari zyrtar i aplikacionit do të merret parasysht. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara me dëshmitë mbështetëse do të refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen, gjithashtu edhe kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t’i nënshtrohen procedurës së punësimit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.